

KONTRATË-DHURIMI

- (KUOTA SHOQËRI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)-

Sot, në Tiranë, më datën 05/ prerit /2020 (dymijë e njëzet), palët:

Bujar Tuku, i biri i Subiut, i datëlindjes 11.10.1956, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga "Haxhi Kika", P.141, shk.1, Apt.7, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal F61011022G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili më poshtë do të referohet "Dhuresi";

dhe

Elvana DESHATI, e bija e Fariut, lindur në Kukës më 01.08.1973 dhe banuese në Tiranë, Rruga Siri Kodra, Pallati Agolli, Shk.1, Apt.8, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr.Personal H35801199T, i cili më poshtë do të referohet "Pranuesja Dhurimit";

KUSHTE PARAPRAKE

Bujar TUKU, me cilësinë ortak i vetëm i shoqërisë "SI" sh.p.k., i rregjistruar në QKB, me NIPT L81707039J, zotëron 1 (një) kuotë të shoqërisë me nje vlerë prej 100 (njëqind) lekë, , të nënshkuara dhe të shlyera tërësisht

Dhuresi është i interesuar dhe ka pranuar që t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit 1 (një) kuotë të shoqërisë me nje vlerë prej 100 (njëqind) lekë të kapitalit.

Pranuesja e Dhurimit, Elvana DESHATI konfirmon mirënjohjen për këtë akt bujar të Dhuresit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë.

Në kuadër të kushteve paraprake të evidentuara më sipër, palët bien dakort të lidhin këtë kontratë dhurimi kuotash, si më poshtë:

NENI 1-OBJEKTI I KONTRATËS

Më anën e kësaj kontrate, palët kanë si qëllim të përcaktojnë kushtet dhe termat, sipas të cilave, Dhuresi, Bujar TUKU konfirmon dhurimin në favor të Pranueses së Dhurimit, Elvana DESHATI, 1 (një) kuotë të shoqërisë me nje vlerë prej 100 (njëqind) lekë, që në total përfaqësojnë 100 % kuota të kapitalit të shoqërisë, si dhe t'i kalojë Pranuesit, cdo të drejtë që buron nga kuotat e përcaktuara në këtë kontratë, ndërsa Pranuesja zotohet t'i pranojë këto kuota të kapitalit.

NENI 2 - VLERA E SENDIT TË DHURUAR

2.1 Dhuresi bie dakord t'i dhurojë dhe t'i transferojë Pranuesit dhe ky pranon 1 kuotë të kapitalit të shoqërisë objekt kontrate, me vlerën prej 100 (njëqind) lekë.

2.2 Palët konfirmojnë se ky dhurim kryhet pa kurrfarë interesi të tanishëm apo të mëvonshëm, barrë apo detyrimi ndaj të tretëve.

NENI 3 - TRANSFERIMI I KUOTAVE

Transferimi i kuotave objekt kontrate do të bëhet efektiv, me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin e Kuotave të Shoqërisë, si edhe në QKR Tiranë.

NENI4- DEKLARIMET DHE GARANCITË E DHURUESIT

4.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton se:

- a) Është pronar i vetëm ligjor dhe përfitues i vetëm i kuotave të përshkruara në këtë kontratë.
- b) Kuotat objekt kontrate janë shlyer plotësisht.
- c) kuotat janë të lira nga cdo lloj barre, pengu apo detyrimi tjetër dhe Dhuruesi ka të drejta të plota, pushtet dhe autoritet për t'i transferuar ato, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate Dhurimi.

4.2 Dhuruesi garanton Pranuesen e Dhurimit se në momentin e ekzekutimit të kësaj kontrate në regjistrin e kuotave të anëtarësisë së shoqërisë së thjeshtë dhe në QKB:

- a) Kuotat objekt kontrate, i japin Pranueses titullin e pakthyesëm të pronësisë mbi këto kuota si dhe cdo të drejtë tjetër që lidhet me zotërimin e tyre;
- b) Dhuruesi humbet pronësinë dhe nuk do të ketë më asnjë të drejtë mbi 1 kuotë objekt kontrate.

NENI 5-LIGJI I ZBATUESHËM

Të drejtat dhe detyrimet e palëve të kësaj kontrate do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin Shqipëtar, posaçërisht Kodi Civil i RSH, Nenet 761 e vijues...

NENI 6 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhen ndërmjet palëve me mirëkuptim dhe nëse nuk arrihet kjo, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në rrugë gjyqësore, duke përcaktuar si gjykatë kompetente, Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

NENI 7 - FORCAT MADHORE

Asnjë prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjës në qoftë se mospërmbushja e detyrimeve kontraktore është rrjedhim i forcës madhore. Do të konsiderohen si forca madhore: revolucionet, kryengritjet popullore, luftërat, grevat, zjarret, përmytjet, tërmetet si edhe ndërhyrjet dhe veprimet e shtetit që kufizojnë lirinë personale apo ato të ndërmarrjes të seciles palë.

NENI 8 - TE NDRYSHME


8.1 Kjo kontratë e shkruar përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, përsa i përket objektit të kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, verbale apo të shkruara dhe të gjitha komunikimet e tjera të mëparshme ndërmjet palëve në lidhje me objektin në fjalë.

8.2 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, cdo ndryshim i kësaj kontrate mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

8.3 Të dyja palët janë dakord se afatet dhe kushtet e kësaj kontrate janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen para një pale të tretë, përveç sa kërkohet ligjërsisht sipas ligjit në fuqi.

8.4 Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga palët.

DHURUES



PRANUESE E DHURIMIT

